

Ç'është screening?

Screening është një program shtetëror për diagnostikimin e parakohshëm të sëmundjeve (tumoreve) për mbrojtjen e shëndetit tuaj:

- është falas;
- është i thjeshtë;
- nuk është i dhimbshëm;
- mund t'a bësh afër shtëpisë;
- nuk kërkohet impenjativë e mjekut;
- data e takimit tuaj është shkruar në letrën personale;
- respekton privatësinë tuaj (Privacy) sipas ligjit në fuqi.



Shkarro APP gratis
për të gjitha informacionet.



Azienda USL di Reggio Emilia
Centro Screening
Lunedì - Venerdì
dalle 8.00 alle 13.00 e dalle 14.00 alle 17.00
telefono 0522.335327
email info.screening@ausl.re.it

Nëse nuk ju ka ardhur letra personale ose doni të informoheni më gjërësisht, mund të telefononi në numrin e Centro Screening



il servizio
sanitario
si prende
cura di te

Merrni pjesë në screening Mbroni shëndetin tuaj



(MAMMOGRAFIA)

Screening i gjurit



Është një ekzaminim falas, i thjeshtë, i shpejtë dhe pa dhimbje.

Screening bëhet nëpërmjet mamografisë (radiografi e gjurit) çdo vit (e moshës 45-49 vjeç) ose çdo 2 vjet (e moshës 50-74 vjeç) dhe shërben për të verifikuar nëse gjiri juaj është normal.

Nëse jeni në moshën 45 deri në 74 vjeç do t'ju ftojme nëpërmjet një letre personale, ku do t'ju jetë caktuar takimi pranë Spitalit të zonës suaj.

Nëse është e nevojshme, mund të ndryshoni datën ose orën e takimit duke telefonuar në numrin e Centro Screening.

Nëse nuk ju ka ardhur letra, telefononi në numrin e Centro Screening.

Përgjigjja në emrin tuaj do t'ju vijë në shtëpi me postë.

Nëqoftëse do të jetë e nevojshme të bëni kontrolle të tjera do t'ju marrim në telefon.



Screening i qafës së murrës (PAP-TEST/HPV)

Është një ekzaminim falas, i thjeshtë, i shpejtë dhe pa dhimbje.

Screening bëhet për të parandaluar ose kapur tumorin në fazën fillestare.

Nëse jeni në moshën 25 deri në 29 vjeç do të bëni PAP Test çdo 3 vjet, nga moshë 30 deri në 64 vjeç do të bëni HPV Test çdo 5 vjet.

Nëse jeni në moshën 25 deri në 64 vjeç, do t'ju ftojme nëpërmjet një letre personale, ku do t'ju jetë caktuar takimi pranë Konsultorit më afër shtëpisë suaj. Nëse është e nevojshme, mund të ndryshoni datën ose orën e takimit duke telefonuar në numrin e Centro Screening.

Nëse nuk ju ka ardhur letra, telefononi në numrin e Centro Screening.

Përgjigjja në emrin tuaj do t'ju vijë në shtëpi me postë. Nëqoftëse do të jetë e nevojshme të bëni kontrolle të tjera do t'ju marrim në telefon.



Screening i zorrës (zorrës së trashë)

(TEST PËR KËRKIMIN E GJAKUT OKULT NË FËÇE)

Është një ekzaminim falas, i thjeshtë, i shpejtë dhe pa dhimbje.

Screening bëhet për të verifikuar nëse ka gjak që nuk shihet me sy në fëçe (jashtëqitje); bëhet çdo 2 vjet.

Nëse jeni në moshën 50 deri në 69 vjeç do t'ju ftojme nëpërmjet një letre personale, ku do t'ju jetë caktuar takimi për të tërhequr flakonin (eprove të) për analizën e fëçes.

Nëse është e nevojshme, mund të ndryshoni datën ose orën e takimit duke telefonuar në numrin e Centro Screening.

Përgjigjja në emrin tuaj do t'ju vijë në shtëpi me postë. Nëqoftëse do të jetë e nevojshme të bëni kontrolle të tjera do t'ju marrim në telefon.

